



Procurar - Prilloga LEP/Dana	13-09-2023
Numri Organizat	02-035/02-1123
Numri/Drejtor	
Shtetjese	
Prillloga	
Vlase	

"YourJob" - Youth Overcoming Unemployment Regionally through Job Opportunities on the
Balkans -Phase II

ADC Nr.: 8365-00/2022

Caritas Austria project Nr.: 2209135

MARREVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të: **Komuna e Vitisë** më tej "Komuna", me adresë, Objekti i Administratës Komunale, Rr 28
Nëntori, 61000 Viti ,të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës **Z. Sokol Haliti**

dhe

Caritas Kosova me adresë në rrugën-Sheshi "Nënë Tereza " nr 3/Kisha Katolike, 70000 Ferizaj- Kosove të
cilën e përfaqëson Don. Viktor Sopi- Drejtor Gjeneral

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje të bashkëpunimit është: **Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta në interes të përgatitjes dhe këshillimit të të rinjve të komunës së Vitisë për tregun e punës.**

Neni 2 Përgjegjësitë dhe obligimet e Komunës:

2.1 Komuna do të ofroj mbështetje profesionale, përmes resurseve njerëzore (zyrtarëve komunal) në mbështetje të realizimit të qëllimit të përcaktuar në pikën 1 të kësaj marrëveshje.

2.2 Komuna do të ofroj mbështetje logjistike-infrastrukturore, për organizimin e aktiviteteve të parapara në projekte të ndryshme, të cilat mundësojnë përgatitjen profesionale për të rinjtë.

2.3 Komuna do të angazhohet në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin edhe më institucione dhe organizata të tjera relevante, përvoja e të cilave mund ti shërbej Caritas-it, në implementimin e suksesshëm të projektit që mbështesin të rinjtë.

2.4 Komuna, përmes drejtorive përkatëse, si: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Rini Kulturë dhe Sport, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe drejtorive të tjera, do të mundësoj qasjen në shkollat dhe institucionet tjera, ku të rinjtë do informohen për shërbimet që ofron Caritas Kosova në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës.

2.5 Komuna do të promovoj projektet dhe mundësitë e ofruara nga Caritas Kosova për të rinjtë në hapësirat zyrtare të komunikimit dhe informimit, si ëeb, facebook page, etj.



Neni 3 Përgjegjësitë, obligimet dhe kontributi i Caritas Kosova

3.1 Caritas Kosova, do të ofroj stafin e vet, (Këshilltarin Social) të cilët do të punojnë drejtpërdrejtë me të rinjtë e komunës, në evidentimin e nevojave të të rinjve për përgatitjen për tregun e punës.

3.2 Caritas Kosova do të mbështes të rinjtë e Komunës nga moshë 15 deri në moshën 30 vjeçare, përmes ofrimit të shërbimeve konsultative dhe përgatitjen profesionale të tyre për nevojat e tregut të punës përmes ofrimit të trajnimeve profesionale dhe akademike.

3.3 Caritas Kosova do të angazhohet në bashkëpunim të ngushtë me bizneset e komunës së Vitisë për tu siguruar për nevojat e bizneseve për kualifikimet e nevojshme profesionale që kërkohen në tregun e punës. Bazuar në këtë analizë, Caritas Kosova do të ju ofroj të rinjve mundësi për punë praktike në bizneset Komunës së Vitisë.

3.4 Caritas Kosova do të ofroj grante për idetë inovative të të rinjve për vetë-punësim, punësim, ndërmarrësi sociale, etj.

3.4 Të gjitha raportet e realizuara dhe hulumtimet e bëra nga Caritas Kosova, do ti jepen në shfrytëzim Komunës, për të ndërtuar politika dhe plane zhvillimore që mbështesin përgatitjen profesionale të të rinjve për punësim.

Neni 4. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

4.1 Mosmarrëveshjet e krijuara nga kjo Marrëveshje palët duhet t'i zgjidhin përmes bisedimeve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Gjilan – dega në Viti.

Neni 5 Përfundimi

5.1 Palët mbajnë të drejtën për të anuluar marrëveshjen e mirëkuptimit në rast të moszbatimit të kësaj marrëveshje sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit.


Neni 6 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje është e lidhur për afat trevjeçare, nga dita e nënshkrimit, por mund të ju shërbej palëve edhe më gjatë, nëse ka pajtueshmëri të dy anshme të shprehur nga palët.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

Komuna e Vitisë
Z. Sokol Haliti



Caritas Kosova
Don. Viktor Sopi- Drejtor Zëjeneral





Me datë 13/09/2023